6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 15

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 16

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme: a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.

b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Neni 17

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

2. Shoqëria njeh, gjithashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.

Neni 18

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.

b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.

3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.

4. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.

5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.

6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.

7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.

c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.

ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

d) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.

dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.

e) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.

ë) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.

f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.

g) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.

gj) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.

h) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.

i) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.

j) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.

k) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.

l) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme,

b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet.

Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme.

c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxhial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

a) Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.

b) Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

c) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.

ç) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).

d) Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsumatori.

dh) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

e) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

Neni 20

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master

shkencor”, në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.

b) Të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.

2. Drejtori tregtar ka këto kompetenca:

a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.

b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.

c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.

ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.

d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

dh) Ushton kontrole periodike mbi veprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.

e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.

ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.

f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë.

g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 21

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:

a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;

b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

ç) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët, që veprojnë në kundër-shtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 22

Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërmbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.

2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 23

Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 24

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrulli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertët kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga

Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 25

Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 26

Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.

2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 27

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Fitimet e akumuluar nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, vlere e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t'i kalojnë dhe do të përdoren nga Bashkia. Fitimet e akumuluar brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 28

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.
- b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e asetëve e të likuiditeteve të tyre.
- c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 29

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30

Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E UKSH

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Prot N.285

Vendim

Nr. 6 datë 21/07/2017

"Mbi miratimin e shteses se kapitalit per SHOQERINE UJESJELLES KANALIZME
SH.A SHKODER

Kryetarja e Asamblese se Pergjithshme ,mbeshtetur ne nenin 135 te ligjit 9901 ,date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare"te ndryshuar ,Lighin nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore ",VKM 63 ,date 27.01.2016 Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem,grumbullimin ,largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"

Vendosi ,

- Te miratoje shtesen e kapitalit i cili eshte rritur 369 475 480 leke
- Kapitali themeltar nga 471 000 000 leke e barabarte me 471 000 aksione me vlere nominale 1000 leke pas bashkimit behet 840,475,000 leke e barabarte me 840 475 aksione me vlere nominale 1000 leke secili
- Vlera e kapitalit te shoqerise Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a pas rritje behet 840,475,000 leke nga te cilat kapital ne natyre 369,475,000 leke dhe kapital ne kesh 471,000,000 leke te cilat zoterohen nga Bashkia Shkoder.

Për Asamblenë e Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizime Shkoder sh.a





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E UKSH

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

P/vot 11284

Vendim

Nr. 5 datë 21/07/2017

"Mbi miratimin e Pasqyrave financiare te vitit 2016 te Shoqerise Ujesjelles Kanalizime Shkoder Sh.a"

Kryetarja e Asamblese se Pergjithshme ,mbeshtetur ne nenin 135 te ligjit 9901 ,date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare"te ndryshuar ,Lighin nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore ",VKM 63 ,date 27.01.2016 Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem,grumbullimin ,largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"

Vendosi ,

- Te miratoje Pasqyrat financiare per vitin financiar 1 Janar - 31 Dhjetor 2016 te Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sipas raportit te auditues te pavarur.
- Fitimi financiar i vitit 2016 ne vleren 377 891 leke (treqind e tridhjetete e shtatemije e teteqind e nentedhjetete e nje leke) nuk do te shperndahej ne formen e dividendit por do te kaloje ne mbulimin e humbjeve te Shoqerise Ujësjetllës Kanalizime Shkodër te akumuluarua nder vite .

Për Asamblenë e Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime Shkoder sh.a

KRYETARE

Voltana ADEMI



Nr. Prot. 802
Data: 14.07.2017

RAPORT PER DHENJE SIGURIE

SHA UJSELLES KANALIZIME SHKODER

Korrik ,2017

Emnur Auditim shpk NIPT L57403004U, Mimeoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:iekank@yahoo.com



Raport per dhenje sigurie
Mbi Verifikimin e shteses se kapitalit per shoqerine UJSELLES KANALIZIME SHA SHKODER

Asamblese se ortakeve
Te nderuar zoterinjt

Ne egzekutim te misionit te ngarkuar nga asambleja e ortakeve e shoqerise suaj per vleresimin e shteses se kapitalit te shoqerise suaj si eksperte kontabel te autorizuar per vleresimin e ketij kapitali ,kemi kenaqesine t,ju paraqes raportin si me poshte vijon.
Ne vendimin e asamblese ne zbatim te vendimit te qeverise ortaket kane vendosur rritjen e kapitalit te shoqerise nga bashkimi i nje pjese te ujsjellesave te fshatit sipas ndarjes se re territoriale ne RSH qe jane ne territorin e Bashkise Shkoder .

Objektivat:

- Verifikimi i rritjes se kapitalit sipas vendimit te asamblese se ortakeve
- Baza Ligjore
- Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite Tregtare ,VKM VKM 63 27.01.2016
- Baza Dokumentare
- Dokumentacioni ligjor i shoqerise,akt themelim statut ,pasqyrat financiare te shoqerise

Te dhenat per shoqerine

Shoqeria Ujësllës Kanalizime SHA Shkodër fillimisht është krijuar 01/07/1996 Rregjistruar prane Gjykatës shkalles pare Tirane me vendimin 24712/3 date 23.11.2000 me NIPT J66902052A Statusi Juridik "Shoqeri anonime me kapital 100% shtetore : Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit 262 100,000 leke ,i ndare ne 262,100 kuota me vlere nominale 1000 leke secila . Selia ndodhet ne Shkoder , lagjja 3 herojte Rruga 3 herojte Objekti i veprimtarise Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij.Mirembajtjen e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem,prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatorve. Sherbimi i grumbullimit,largimit dhe trajtimit te urjave te ndotura.Mirembajtja e sistemeve te urjave te ndotura,si dhe te impjanteve te pastrimit te tyre.

Per te realizuar objektivat e operacionit te vleresimit jam bazuar ne pasqyrat financiare te shoqerise ne vitin 2016 . Te dhenat e pasqyrave financiare plotesoje kushtet e auditimit ligjore dhe jane te certifikuar nga eksperte kontabel te rregjistruar .

ARSYEJA DHE MENYRA E VLERESIMIT

Kapitali i shoqerise Ujësllës Kanalizime Shkodër sha eshte si me poshte Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit 262 100,000 leke.
Me vendimin nr 24712/3, Gjykata:Tirane dt 03/06/2005 Depozitim e Urdherit nr.142date 24.05.2005 te Ministris te Ekonomise Publike dhe Privatizimit,ne clesin e aksionerit te vetem te shoqerise, per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me vleren e objektit "Salla e Klinetes" (sportelet), kati i pare, prej 36 374 994 leke e barabarte me 36 374,9 aksione me vlere nominale 1000 leke secili dhe kapitali themeltar behet 298 474 994 leke e barabarte me 298 474,9 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Me vendimin nr Numri i Vendimit:24712/4, Gjykata:Tirane dt 24/06/2005 Depozitim e Urdherit nr.189 date 21.06.2005 te Ministris te Ekonomise Publike dhe Privatizimit,ne clesin e aksionerit te vetem te shoqerise,per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me pershirjen e rezervave prej 172 525 006 leke e barabarte me 172 525

Emnur Auditim shpk NIPT L57403004U, Mimeoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:iekank@yahoo.com



aksione me vlere nominale 1 000 leke secili dhe kapitali themeltar behet 471 000 000 leke e barabarte me 471 000 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili

Me daten 30/05/2011 Eshte bere depozitimi I Depozitimi i Urdherit Nr.1013 date 14.02.2007,Urdherit Nr.1044 dtae 19.12.2007 dhe Nr.1029 date 19.12.2007, te Ministris te Ekonomise Publike, Tregtise dhe Urdhertes z.Genc Ruli.Depozitimi i Statutit nr.1029 Prot, date 19.12.2007 Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortaket juridik: eshte shtuar ortaku: ("Bashkia Shkoder") Numri i aksioneve"471.000,00 Perqindja ne kapital "100,00" Kontributi ne para "471.000.000,00

Me daten 29/06/2016 Depozitimi i vendimit te asamblese date: 01.06.2016, ne te cilin eshte vendosur: Miratimi i statutit te ri te shoqerise ne perputhje me VKM 63.Emri i subjektit ishte ("Ujësllës Qytet Shkoder") u be ("Ujësllës Kanalizime Shkodër")

Kerkohe te behet rritja e kapitalit themeltare te shoqerise nga bashkimi i asteve dhe kapitaleve te disa fshatrave qe jane nen juridiksionin e bashkise Shkoder sipas ndarjes se re territoriale duke u bazuar ne te dhenat kontabel dhe fizike te 31.12.2016.

PJESMARRJA NE KAPITALIN THEMELTAR

Sipas statutit te shoqerise ,, Ortak i vetem i shoqerise Ujësllës Kanalizime Shkodër eshte Bashkija Shkoder me 100% te aksioneve . Ne perputhje me ligjin per shoqerite tregtare si dhe normat dhe standartet e profesionit te EKA ne kemi marre te gjithe informacionin e nevojshem per te bere vleresimin e ketyre kontributeve qe lidhen me rritjen e kapitalit te shoqerise ("Ujësllës Kanalizime Shkodër")dhe konstatojme si me poshte : Vlera kesh 100.000 leke , eshte rregjistruar ne momentin e themelimit te shoqerise e vertetuar nga skeda historikut te rregjistrimit leshuar nga QKR.

Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit 262 100,000 leke ,i ndare ne 262,100 kuota me vlere nominale 1000 leke secila . Me vendimin nr 24712/3, Gjykata:Tirane dt 03/06/2005 kapitali themeltar behet 298 474 994 leke e barabarte me 298 474,9 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Me vendimin nr Numri i Vendimit:24712/4, Gjykata:Tirane dt 24/06/2005 kapitali themeltar behet 471 000 000 leke e barabarte me 471 000 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili Tani kerkohe te behet shtesa e kapitalit nga bashkimi i disa pjeseve te ujsjellesve te fshatrave si me poshte :

	vlera fillestare	amortizim	vlera mbetur	kapitali sipas QKR	VKM 63 27.01.2016	OSHEE
ujesllesi theth	50,924,917		50,924,917		50,924,917	
ujesllesi theth	3,844,548	2,498,956	1,345,592		1,345,592	
ujesllesi ndrej	11,239,233	7,905,501	3,933,732		3,933,732	
ujesllesi pemsa	1,068,009	694,206	373,803		373,803	
ujesllesi postribe				32,806,940		
ujesllesi kullaj	149,799,163	62,865,717	86,933,446		86,933,446	
ujesllesi dragoc (postribe 1 viti 2014)	2,365,120		2,365,120		2,365,120	
ujesllesi domen	361,920	26,274	335,646		335,646	
ujesllesi boks,qender,milan dragoc	415,860		415,860		415,860	
ujesllesi rrasek komuna postribe	3,808,820	2,285,292	1,523,528		1,523,528	

Emnur Auditim shpk NIPT L57403004U, Mimeoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:iekank@yahoo.com



	15,263,888		15,263,888		15,263,888	
ujesllesi dragoc				61,384,700		
ujesllesi rrethina					12,289,969	
ujesllesi hot i ri	18,706,193	6,416,224	12,289,969		3,986,962	
gucl e re	6,068,436	2,081,474	3,986,962		7,049,084	
shtoj i ri	10,729,200	3,680,116	7,049,084		14,489,814	
grud e re	22,054,511	7,564,697	14,489,814		3,633,988	
vinoteke	5,531,184	1,897,196	3,633,988		5,151,169	
shtoj i vjeter	7,840,440	2,689,271	5,151,169		5,156,420	
hot i ri	7,848,432	2,692,012	5,156,420		4,867,055	
puset e ujit	7,407,998	2,540,943	4,867,055		4,753,781	
stacioni pompimit	7,235,588	2,481,807	4,753,781		3,110,263	
ndertim pusetave guri i zi	5,798,402	2,688,139	3,110,263		28,583,906	
ujesllesi guri i zi	53,288,415	24,704,509	28,583,906	31,698,320		
ujesllesi guri i zi					1,404,498	
ujesllesi zogaj	14,044,979	12,640,481	1,404,498		232,512	
ujesllesi muriqan	2,325,122	2,092,610	232,512		2,997,651	
ujesllesi zues	29,976,505	26,978,855	2,997,651		15,972,340	
ujesllesi oblike					13,802,678	
ujesllesi bardice mesme	60,511,522	46,708,844	13,802,678	24,841,300	4,594,937	
ujesllesi bardice sipërme	20,144,396	15,549,459	4,594,937		6,440,341	
ujesllesi bardice mali hebe	28,234,725	21,794,384	6,440,341		24,061,160	
ujesllesi dajc	24,061,160		24,061,160		55,401,198	
ujesllesi shkoder	69,251,498	13,850,300	55,401,198		7,503,974	
rrethimi ujsjellesi shkoder 1	9,379,967	1,875,993	7,503,974		1,982,933	
rrethimi ujsjellesi shkoder 2	2,478,666	495,733	1,982,933		19,387,672	
ujesllesi bahcallek	24,234,580	4,846,918	19,387,672		394,297,495	24,822,015
	676,243,407	281,945,912	394,297,495	190,764,760	369,853,371	

Pasqyrave financiare te shoqerise me 31.12.2016

► Kapitali dhe Rezervat	22	840,475,480	471,000,000	369,475,480
► Rezerva te tjera	26	2,561,720	2,561,720	0
1 Rezerva ligjore	26.1	2,561,720	2,561,720	0

Emnur Auditim shpk NIPT L57403004U, Mimeoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:iekank@yahoo.com



2 Rezerva statutare	26.2			0
3 Rezerva te tjera	26.3			0
► Fitimi i pashpërndarë	27	-22,138,608	-20,937,768	-1,200,840
► Fitim / Humbja e Vitit	28	377,891	-1,200,840	1,578,731
Totali i Kapitalit		821,276,483	451,423,112	369,853,371

Kapitali aksionier eshte rritur 369,475,480 leke dhe kjo rritje ka ardhur nga :
vlera e asetave te marra me vlere fillestare sipas listes qe i bashkangjitet ketij raportit 676,243,407
Amortizimi I akumuluar per keto aset
(281,945,912)
Detyrime te pranuar per oshee
(24,822,015)
Kapitali qe merret
369,475,480

Kapitali pas bashkimit behet 840,475,000 leke e barabarte me 840 475 aksione me vlere nominale 1 000 leke secil dhe zoterohet nga Bashkija Shkoder
Vlera 480 1 shtohet rezervave te tjera qe behen 2,562,200 leke

SI PERFUNDIM

Ne shpirtimin e parqyrtimit te dokumentacionit konstatojme qe vlera e paraqyrtuar nga shoqeria "Ujësllës Kanalizime sha Shkodër per rritjen e e kapitalit , te pranohet per 369,475,000 leke . Kjo vlere eshte kapital ne natyre .


Vlera e kapitalit te shoqerise Ujësllës Kanalizime sha Shkodër pas rritjes behet 840,475,000 leke nga te cilat kapital ne natyre 369,475,000 leke dhe kapital ne kesh 471,000,000 leke .

Ky kapital eshte i barabarte me 840 475 aksione me vlere nominale 1 000 leke secilin aksion dhe zoterohet nga bashkija Shkoder

Shoqeria ENNUR Auditim shpk

EKSPERTE angazhimi
Nurije krymi

(Signature)



Eksperet kontabel rregjistruar
EKSPERTE Mimeoza Fishta
KAPITULIM
(Signature)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E UKSH

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr. Prot. 18849

Vendim

Nr. 8 datë 18 / 12 / 2017

"Mbi miratimin e shtesës së kapitalit për SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A SHKODËR.

Kryetarja e Asamblese se Përgjithshme ,mbeshtetur në nenin 135 të ligjit 9901 ,datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar ,Ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ",VKM 63 ,datë 27.01.2016 Per riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shëbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimin ,largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura"

Vendosi ,

- Te miratojë rritjen e kapitalit për 22,993,000 lekë.
- Kapitali themeltar nga 840,475,000 lekë e barabarte me 840 475 aksione me vlerë nominale 1000 lekë, pas bashkimit bëhet 863,468,000 lekë e barabartë me 840 475 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili.
- Vlera e kapitalit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a pas rritjes bëhet 863,468,000 lekë nga të cilat kapital në natyrë 392,468,000 lekë dhe kapital në kesh 471,000,000 lekë të cilat zotërohen nga Bashkia Shkodër.

Për Asamblenë e Përgjithshme te Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a



RAPORT PER DHENJE SIGURIE

SHA UJESJELLES KANALIZIME SHKODER

DHJETOR ,2017

Ennur Auditim shpk NIPT L57403004U,Mimoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:rekank@yahoo.com

Raport per dhenje sigurie se kapitalit per shoqerine UJESJELLES KANALIZIME SHA SHKODER

Asamblese se ortakeve

Te nderuar zoterinj

Ne egzekutim te misionit te ngarkuar nga asambleja e ortakeve e shoqerise suaj per vleresimin e shteses se kapitalit te shoqerise suaj si eksperte kontabel te autorizuar per vleresimin e ketij kapitali ,kemi kenaqesine t,ju paraqes raportin si me poshte vijon.
Ne vendimin e asamblese ne zbatim te vendimit te qeverise ortaket kane vendosur rritjen e kapitalit te shoqerise nga bashkimi i nje pjese te ujsjellesava te fshatit sipas ndarjes se re territoriale ne RSH qe jane ne territorin e Bashkise Shkoder .

Objektivat:

- Verifikimi i rritjes se kapitalit sipas vendimit te asamblese se ortakeve
- Baza Ligjore
- Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite Tregtare ,VKM nr. 63 27.01.2016
- Baza Dokumentare
- Dokumentacioni ligjor i shoqerise ,akt themelim statut , pasqyrat financiare te shoqerise

Te dhenat per shoqerine

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime SHA Shkoder fillimisht eshte krijuar 01/07/1996
Rregjistruar prane gjykates shkalles pare Tirane me vendimin nr 24712 date 23.11.2000 me NIPT J66902052A
Statusi Juridik "Shoqeri anonime me kapital 100% shtetore :
Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit ishte 262 100,000 leke ,i ndare ne 262,100 kuota me vlere nominale 1000 leke secila .
Selia ndodhet ne Shkoder , Lagjja 3 Herojte Rruga 3 Herojte
Objekti veprimtarise
Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij,mirembajtjen e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem,prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatorve.
Sherbimi i grumbullimit,largimit dhe trajtimit te urjave te ndotura.Mirembajtja e sistemeve te urjave te ndotura,si dhe te-impjanteve te pastrimit te tyre.

Per te realizuar objektivat e operacionit te vleresimit jemi bazuar ne pasqyrat financiare te shoqerise ne vitin 2016 . Te dhenat e pasqyrave financiare plotesoje kushtet e auditimit ligjore dhe jane te certifikuar nga eksperte kontabel te regjistruar .

ARSYEJA DHE MENYRA E VLERESIMIT

Kapitali i shoqerise Ujesjelles Kanalizime Shkoder sha eshte si me poshte:
Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit 262 100,000 leke.
Me vendimin nr 24712/3, dt 03/06/2005 te Gjykates Tirane eshte bere Depozitimi I Urdherit nr.142date 24.05.2005 te Ministris te Ekonomise Publike dhe Privatizimit,ne cilesin e aksionerit te vetem te shoqerise ,per zmachimin e kapitalit te shoqerise me vleren e objektit "Salla e Klientes" (sportelet), kati i pare, prej 36 374 994 leke e barabarte me 36 374,9 aksione me vlere nominale 1000 leke secili dhe kapitali themeltar behet 298 474 994 leke e barabarte me 298 474,9 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Me vendimin nr 24712/4 dt 24/06/2005 te Gjykates Tirane eshte bere depozitimi i Urdherit nr.189 date 21.06.2005 te Ministris te Ekonomise Publike dhe Privatizimit,ne cilesin e aksionerit te vetem te shoqerise,per

Ennur Auditim shpk NIPT L57403004U,Mimoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:rekank@yahoo.com

ndachimin e kapitalit te shoqerise me perfshirjen e rezervave prej 172 525 006 leke e barabarte me 172 525 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili dhe kapitali themeltar behet 471 000 000 leke e barabarte me 471 000 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili

Me datej 30/05/2011

Eshte bere depozitimi i Urdherit Nr.1013 date 14.02.2007,Urdherit Nr.1044 dae 19.12.2007 dhe Nr.1029 date 19.12.2007, te Ministris te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes z.Genc Ruli.Depozitimi i Statutit nr.1029 Prot, date 19.12.2007
Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortaket juridik:
Eshte shtuar ortaku: ("Bashkia Shkoder") Numri i aksioneve"471,000,00 Perqindja ne kapital "100,00" Kontributi ne para "471.000.000,00

Me daten 29/06/2016 eshte bere depozitimi i vendimit te asamblese date: 01.06.2016, ne te cilin eshte vendosur: Miratimi i statutit te ri te shoqerise ne perputhje me VKM 63.
Emri i subjektit ishte ("Ujesjelles Qytet Shkoder") u be ("Ujesjelles Kanalizime Shkoder")

Me daten 04/08/2017

Eshte bere rritja e kapitalit ne zbatim te VKM 63 per bashkimin e ujesellesave te fshatrave ne juridiksionin e bashkise Shkoder .
Ne perputhje me ligjin in shoqerite tregtare si dhe normat e profesionit te EKA ne kemi marre te gjitha informacionin e nevojshem per te bere vleresimin e ketyre kontributeve qe lidhen me rritjen e kapitalit te shoqerise ("Ujesjelles Kanalizime Shkoder")dhe konstatojme si me poshte :

Kapitali Themeltare ne momentin e themelimit 262 100,000 leke ,i ndare ne 262,100 kuota me vlere nominale 1000 leke secila .
Me vendimin nr 24712/4 dt 24/06/2005 te Gjykates Tirane eshte bere depozitimi i Urdherit nr.189 date 21.06.2005 te Ministris te Ekonomise Publike dhe Privatizimit,ne cilesin e aksionerit te vetem te shoqerise,per zmachimin e kapitalit te shoqerise me perfshirjen e rezervave prej 172 525 006 leke e barabarte me 172 525 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili dhe kapitali themeltar behet 471 000 000 leke e barabarte me 471 000 aksione me vlere nominale 1 000 leke secili

Me daten 04/08/2017 Eshte bere rritja e kapitalit ne zbatim te VKM 63 per bashkimin e ujesellesave te fshatrave ne juridiksionin e bashkise Shkoder .
Kapitali u be 840,475,000 leke ortaku: ("Bashkia Shkoder") Numri i aksioneve"840.475,00 Perqindja ne kapital "100,00" Kontributi ne para "471,000,000 ,00leke dhe ne natyre 369,475,000 leke

Tani kerkohet te behet shtesa e kapitalit nga bashkimi i disa pjeseve te ujsjellesva te fshatrave te velipojes si me poshte :

Ennur Auditim shpk NIPT L57403004U,Mimoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:rekank@yahoo.com

	vlere fillestare	amortizim	vlere mbetur
ujesjelle velipoje sit perfundimtare per rec qendrar huazte gomsiqe velipoje viti 2003	49,508,120	32,180,278	17,327,842
faza III linja plazh ,reabilitim rezervari gomsiqe VITI 2004	42,449,280	25,469,568	16,979,712
ujesjellesi trush faza I viti 2008	155,394,034	69,927,315	85,466,719
ujesjellesi trush faza II viti 2009	110,222,276	44,088,910	66,133,366
UJESJELLES REC I VJETER 2011-2013	34,777,757	6,955,551	27,822,206
REZERVARI I BOKSIT DHE RECIT VITI 2014-2015	70,294,115	10,544,117	59,749,998
STACIONI TRUSH VITI 2015	46,275,760	4,627,576	41,648,184
STACIONI TRUSH DHE RRJETI FSHATI VELIPOJE VITI 2016	62,407,663	3,120,383	59,287,280
makineri dhe pajise te implantit ujave perdorura	173,776,027	104,265,615	69,510,412
	745,105,032	301,179,314	443,925,718

Duke verifikuar te gjitha zerat e mesiperm na rezultojn se te gjitha investimet e bera jane grande dhe si te tilla duhet te konsiderohen edhe gjate kalimit nga ujsjellesi fshat ne shoqerine ujsjelles kanalizime Shkoder .
Po ashtu duhet te marrim ne konsiderate detyrmet qe keto subjekte kane me OSHEE per energji te pa paguar deri ne momentin e kalimit qe eshte nenor 2017.
Nga te dhenat e Pasqyrave Financiare te ujsjellesit Fshat rezultojn se kapitali aksionier i Velipojes eshte 22,993,600 leke

	vlere fillestare	amortizim	vlere mbetur	kapitali sipas QKR	VKM 63 27.01.2016	OSHEE
ujesjelle velipoje sit perfundimtare per 2003 rec qendrar huazte gomsiqe velipoje	49,508,120	32,180,278	17,327,842			
faza III linja plazh ,reabilitim rezervari gomsiqe VITI 2004	42,449,280	25,469,568	16,979,712			
ujesjellesi trush faza I viti 2008	155,394,034	69,927,315	85,466,719			
ujesjellesi trush faza II viti 2009	110,222,276	44,088,910	66,133,366			
UJESJELLES REC I VJETER 2011-2013	34,777,757	6,955,551	27,822,206			
REZERVARI I BOKSIT DHE RECIT VITI 2014-2015	70,294,115	10,544,117	59,749,998			
STACIONI TRUSH VITI 2015	46,275,760	4,627,576	41,648,184			
STACIONI TRUSH DHE RRJETI FSHATI VELIPOJE VITI 2016	62,407,663	3,120,383	59,287,280			
makineri dhe pajise te implantit ujave perdorura	173,776,027	104,265,615	69,510,412			
	745,105,032	301,179,314	443,925,718	22,993,600	369,586,241	51,345,877

Pasqyrave financiare te shoqerise me 31.12.2016 dhe ndryshimet e fundit jane si me poshte

Kapitali dhe Rezervat	22	30/11/2017	31/07/2017	Ndryshimi
Rezerva te tjera	26	863,468,000	840,475,000	22,993,000
1 Rezerva ligjore	26.1	2,562,800	2,562,200	600
2 Rezerva statutore	26.2			600

Ennur Auditim shpk NIPT L57403004U,Mimoza Fishta NIPT K96517004C
Adresa Rruga Studenti pallati hipotekes kati pare Shkoder Tel/Cel :0682087087 E-mail:rekank@yahoo.com

	26.3			
3 Rezerva te tjera	26.3			
Fitim i pashperndare	27	-22,138,608	-22,138,608	
Fitim / Humbnja e Vitit	28	377,891	377,891	
Totali i Kapitalit		844,270,083	821,276,483	22,993,600

Kapitali aksionier eshte rritur 22,993,000 leke dhe kjo rritje ka ardhur nga :
vlera e aseteteve te marra me vlere fillestare sipas listes se mesiperm sipas zerave
Asetet te marra me vlere fillestare 745,195,032
Amortizim (301,179,314)
Asete te marra me vlere neto 443,925,718
Detyrime nga OshE deri 30.11.2017, 51,345,877
Grande per investime te bera 369,586,241
Gjithsejt detyrime 420,932,118
Kapitali aksionier i sektorit Velipoje 22,993,600 leke
Nga ky kapital behet rritje 22,993,000 leke ne kapital dhe 600 leke ne rezerva


Kapitali pas bashkimit behet 863,468,000 leke e barabarte me 863,468 aksione me vlere nominale 1 000 leke secilidhe zoterohet nga Bashkia Shkoder
Vlera 600 shtohet rezervave te tjera qe behen 2,562,800 leke

SI PERFUNDIM

Ne shqyrtimin e pergjithshem te dokumentacionit konstatojme qe vlere e paraqitur nga shoqeria "Ujesjelles Kanalizime sha Shkoder per rritjen e e kapitalit , te pranohet per 22,993,000 leke .Kjo vlere eshte kapital ne natyre .

Vlera e kapitalit te shoqerise Ujesjelles Kanalizime sha Shkoder pas rritjes behet 863,468,000 leke nga te cilat kapital ne natyre 392,468,000 leke dhe kapitali ne kesh 471,000,000 leke .

Ky kapital eshte i barabarte me 863,468 aksione me vlere nominale 1 000 leke secilin aksion dhe zoterohet nga bashkija Shkoder



Eksperte Kontabel Rregjistruar
Mimoza Fishta
MIMOZA FISHTA
EKSPERTE KONTABEL
AUTORIZUAR